

A jeni Shtatzanë apo Nxënës që je dhe prind?

Titulli Federal IX dhe Rregullorja 234 e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias shpjegojnë të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja arsimore.

- Titulli IX, Kodi 20 i SHBA-së § 1681 et. seq. është një ligj federal që ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë, në çdo aktivitet shkollor dhe jashtëshkollor. Ky ligj përfshin rregulla për të eliminuar diskriminimin për shkak të shtatzanisë dhe statusit prindëror. Të gjitha shkollat publike, private, rrethet shkollore, kolegjet / universitetet që marrin fonde federale duhet të jenë në përputhje me Titullin IX.
- Rregullat 234, shtatzania / prindër / nxënës të martuar" theksojnë se çdo nxënës që ka të drejtë të ndjekë shkollat e drejtorisë arsimore, dhe kush është i martuar /dhe ose shtatzanë / prindër nuk do ti mohohen programe arsimore për shkak të martesës, shtatzanisë, probleme shëndetësore të lidhura me shtatzaninë, ose pse janë prindër.

Çfarë duhet të dinë nxënësit shtatzanë / prindër / të martuar:

- ❖ Shkolla juaj duhet të ketë një "**Teen Parent Student Liason**" (TPSL). Kjo/Ky mund të jetë infermierja, këshilltari, drejtori ose zëvendës/drejtori. Ata do të sigurojnë që ky informacion të jetë i postuar, që nxënësit shtatzanë / prindër / të martuar të njohin të drejtat e tyre dhe të marrin ndihmën e duhur në shkollë (Programi ELECT) dhe jashtë shkollës. Gjithkush në shkollë duhet të dijë se kush është TPSL.
- ❖ Ju keni të drejtë të vazhdoni të merrni pjesë në klasa dhe aktivitete jashtëshkollore. Ju nuk ju kërkohet të jepni një shënim mjekësor që provon se mund të merrni pjesë, përveç nëse çdo nxënës që vizitohet tek doktori sjellë një shënim për të treguar se është në gjendje të mirë shëndetësore për të marrë pjesë.
 - Nëse ka një program / aktivitet për nxënësit shtatzanë, që ju nuk doni të merrni pjesë nuk ju kërkohet .
 - Ju mund të keni nevojë për disa rregulla shtesë për të siguruar që ju të merrni pjesë **plotësisht** në programet tuaja shkollore dhe jashtëshkollore. Kjo mund të thotë:
 - Planifikoni fleksibilitetin për të reduktuar vonesën / mungesën e lidhur me shtatzaninë.
 - Koha shtesë për lëvizjet nga një klasë në tjetrën, për të vajtur në banjo dhe për të përdorur ashensorin.
 - Sigurimi i detyrave të klasës dhe detyrave të shtëpisë të humbura gjatë mungesave të justifikuara.
 - Aktivitete alternative për të plotësuar kërkesat e fiskultures nëse ju dhe mjeku juaj e kërkojnë këtë gjatë shtatzanisë.
 - Mund të krijohen rregulla të tjera me TPSL-in tuaj, me mësuesit dhe me administratën e shkollës.

- ❖ Ju keni të drejtë **të ushqeni me gji fëmijën në shkollë**. Kjo përfshin:
 - Të keni një dhomë private dhe të sigurt, përveç banjës, për të ushqyer fëmijën tuaj - kjo dhomë duhet të përfshijë aksesin në një burim energjie. TPSL-ja e shkollës duhet t'ju tregojë se ku është kjo dhomë para se të shkoni atje me fëmijën.
 - Leje për të sjellë një pompë gjiri (dhe çdo pajisje tjetër që ju nevojitet për pompimin) në shkollë.
 - Një vend të sigurt për të ruajtur qumështin tuaj derisa të jeni gati për të shkuar në shtëpi
 - Një sasi të arsyeshme kohe (20-30 minuta) për të pompuar / gji dhe mundësinë për të bërë ndonjë detyrë shkollore, në mënyrë që të mos merrni dënime akademike për shkak të ushqyerjes me gji.
- ❖ Nxënësve shtatzanë u lejohe të mbajnë rrobat e duhura të maternitetit që përputhen me ngjyrat uniforme të shkollës së tyre. Nxënësve shtatzanë nuk mund tu mohohet pjesëmarrja në shkollë ose mohimi i një edukimi për mosplotësimin e rregulores së uniformës shkollore , për shkak të shtatzanisë.
- ❖ Kur nuk frekuentoni shkollën në rregull për arsye që lidhen me shtatzaninë / prindërimin, mungesat **Justifikohen** nëqoftese paraqisni dokumentacionin e duhur. Ju duhet të bëni të gjitha përpjekjet për të caktuar takimet në ditët jo shkollore për të mësuar sa më shumë që të jetë e mundur.
 - **Mungesat e justifikuara afatshkurtra, ardhja me vonesë dhe dalje para kohe nga shkolla.**
 - Nëse fëmija juaj është i sëmurë ose ka takim me doktorin, mungesat ose vonesat duhet të justifikohen. Kërkimi i një anëtarit të familjes ose të një miku për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe kujdesin e fëmijës suaj mund të ndihmojnë që fëmijët tuaj të shpenzojnë më shumë kohë në klasë për të mësuar.
 - Nëse keni bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar çerdhe/kopësht për fëmijën (si aplikimi për CCIS ose të gjeni person që të kujdeset për fëmijën) mungesat për këtë shkak duhet të justifikohen. Ju duhet të tregoni se çfarë përpjekjesh keni bërë.
 - **Mungesat e justifikuara afatgjata dhe largimi i prindërve të rinj.**
 - Nxënësit kanë të drejtë në tridhjetë (30) ditë që mungesat të justifikohen për sëmundje / gjëndje shëndetësore gjatë shtatzanisë, për lindje dhe kurim. Ju duhet të jepni një shënim të mjekut me datën e lindjes. Nëse mjeku thotë se ju duhet të qëndroni më gjatë, shënimi nga mjeku duhet të përfshijë kohëzgjatjen .
 - **Ju lejohe të ktheheni në të njëjtin status shkollor dhe jashtëshkollor siç ishit para se të largoheshit.** Kjo do të thotë që ju lejohe të merrni detyrat tuaj gjatë kohës së pushimit dhe / ose të keni një kohë të arsyeshme për të plotësuar të gjitha detyrat kur të ktheheni. Nëse një pjesë e notave bazohet në pjesëmarrjen juve duhet t'ju jepet mundësia për të fituar ato pikë në një mënyrë tjetër.

Kujdes: Nëse një nxënës shtatzanë ka arsye mjekësore që e kufizon pjesëmarrjen në programin e rregullt shkollor, është përgjegjësi e nxënësit / kujdestarit që t'i sigurojë shkollës dokumentacionin e duhur nga mjeku. Nxënësi nuk mund të marrë edukim në shtëpi për arsye të shtatzanisë ose për mungesë të

erdhe/kopësht. Kriteret e përshtatshmërisë për mësimin në shtëpi janë të njëjta për të gjithë nxënësit në distrikt.

- ❖ **Konfidenciali** -Ju keni të drejtën të mbani të fshehta të dhënat tuaja shëndetësore dhe personale lidhur me shtatzaninë dhe kushtet e lidhura me to. Përjashtim mund të ketë vetëm po të kemi abuzim të fëmijës,ose kur neglizhenca shkakton rrezik për shëndetin dhe sigurinë tuaj.
 - Nëse nuk i keni thënë kujdestarit tuaj për shtatzëninë tuaj, shkolla mund t'ju mbështesë me këtë, por ju nuk mund të detyroheni ti tregoni kujdestarit tuaj.
- ❖ **Programi ELECT** i Drejtorisë Arsimore mbështet nxënëset shtatzana dhe prindërit e rinj për të arritur potencialin e tyre më të lartë, si personal ashtu dhe akademik, gjithashtu ti ndihmojnë që ata të jenë prindër dhe qytetarë të suksesshëm. Programi siguron mbështetje për nxënësit të marrin diplomën ose çertifikatën e GED / HSE.
 - Nëse e njoftoni shkollën mbi gjëndjen tuaj të shtatzanisë / prindërimit, duhet të informoheni për shërbimet e programit ELECT.
 - Nëse pranoni të takoheni me ELECT për të dëgjuar më shumë rreth programit, personi në fjalë, **TPSL** infermierja, këshilltari, administratori ose çdo person tjetër i shkollës duhet të dërgojë një formular referimi në programin ELECT.

Nxënëset shtatzana dhe prindërit e rinj kanë të njëjtat të drejta si çdo nxënës tjetër për të ndjekur shkollën dhe për ta bërë këtë në një mjedis pa diskriminim ose ngacmim



Ndërtesa Teen Parent Student Liaison

(TPSL) is: _____

Dhoma e laktacionit në këtë ndërtesë është: _____

